

Arrestohet një 25-vjeçar në Gjakovë, i konfiskohet një AK 47 dhe 60 fishekë



19/07/2023 18:12

f

🐦

🔗

Një person është arrestuar sot në Gjakovë pasi dyshohet për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe të njëjtit i është konfiskuar një armë dhe municion.

25-vjeçari, F.U., dyshohet se ka shtënë më armë zjarri në rrugën “Gasper Karaqi” në Gjakovë.

“Stacioni Policor në Gjakovë, derisa ishin duke hetuar dhe trajtuar një rast shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, kanë arritur të identifikojnë dhe të arrestojnë të dyshuarin F. U., (mashkull, shtetas i Republikës së Kosovës, lindur në vitin 1998), mbi dyshimin e arsyeshëm se i njëjti me datën 14.07.2023 kishte shtënë më armë zjarri në rrugën “Gasper Karaqi” në Gjakovë.

Në shtëpinë e të dyshuarit është konfiskuar një pushkë automatike AK47 (që dyshohet të jetë përdorur në rastin e raportuar), një karikator dhe 60 copë fishekë të po të njëjtës armë.

Me vendim të prokurorit të shtetit, në koordinim me të cilin janë ndërmarr të gjitha veprimet hetimore, i dyshuarit është dërguar në mbajtje”, thuhet në njoftim.



Artikuj të ngjashëm

- July 20, 2023

Banorë të “Rrugës C” protestojnë sot, kjo është arsyeja
- July 20, 2023

Posta e lëshon në qarkullim pullën postare “Shekulli i teknologjisë”
- July 20, 2023

Arrestohet gjakovari, sekuestrohen 11 gëzhoja të fishekëve
- July 20, 2023

Zhduket një kosovar, ishte duke u nisur për në Gjermani
- July 20, 2023

Publikohet identiteti i personit që dyshohet se sulmoi Aliun në Mitrovicë
- July 20, 2023

AAK-ja mban tryezë diskutimi për situatën politike në vend

- LAJME TË FUNDIT
- Banorë të “Rrugës C” protestojnë sot, kjo është arsyeja
- Posta e lëshon në qarkullim pullën postare “Shekulli i teknologjisë”
- Vidal ‘godet’ Sampaoлин, e quan trajner humbës
- Arrestohet gjakovari, sekuestrohen 11 gëzhoja të fishekëve